



Gjimnazi "JETA E RE" - Suharekë

Nr. i protokolit: 724
Datë: 02.09.2025

FTESË PËR OFERTË - Nr. 02 / 2025

Gjimnazi "JETA E RE" në Suharekë kërkon nga Operatorët Ekonomik që merren me rrobaqepësi, të bëjnë ofertë për pajisjen e nxënësve të shkollës sonë me uniforma. Uniformat për femra do të jenë mantele ndërsa për djem do të jenë xhaketa.

Operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit së bashku me dokumentet tjera përcjellëse.
2. Vërtetimi i taksave Komunale (certifikata) për tremujorin e fundit të vitit 2025 në emër të operatorit ekonomik.
3. Formulari me çmimin e ofruar nga ofertuesi (ky dokument merret në drejtorinë e shkollës).
4. Duhet të dorëzojnë të paktën nga një model mantele dhe xhakete të materialit Alpako.
5. Në uniformë duhet të jetë e shtypur logo dhe emri i shkollës.

Fitues i ofertës do të shpallet Operatori Ekonomik i cili i plotëson dokumentet e kërkuara dhe që e ka ofertën më të volitshme të vlerësuar nga komisioni i përbërë nga anëtarë të KDSH-së.

Afati për tërheqje të formularit të ofertave është 7 ditë pune prej datës: 02.09.2025 deri më: 10.09.2025 në drejtorinë e Gjimnazit "JETA E RE" në Suharekë.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më: 10.09.2025 në ora 13:30.

Hapja e ofertave bëhet në prani të Operatorëve Ekonomik në ora 14:00, në Gjimnazin: "JETA E RE".

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bënë komisioni i përbërë nga anëtar të KDSH-së.




Drejtori: Fadil Elshani, prof.

Rr.: "Parku i Dëshmorëve" 23000 Suharekë, Kosovë
Tel. 029/210- 261 , e-mail: gjjetaere@hotmail.com